



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kuvendi i Komunës në Malishevë
Komisioni Vlerësues
Nr./_____
Datë: 02.05.2025

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMIJENË:

Nr. Nën. D.

02/07/2025

02/117

Komisioni Vlerësues, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/111, dt.07.03.2024, si dhe duke vepruar sipas dispozitave Ligjore të Ligjit, nr.06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, neni 19, Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, neni 21 par.21.3, Thirrjes Publike për shprehjen e Interesit sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, Thirrja nr.01/88, dt.07.04.2025,

Komisioni Vlerësues me datë 02.05.2025, bënë këtë;

NJOFTIM PUBLIK

Komisioni duke vepruar në harmoni me Rregullorën e lartëcekur, si dhe evidentimin e dokumentacionit, ka konstatuar se kemi pasur tri oferta, sipas thirrjes publike që mbanë numrin 01/88, dt.07.04.2025 dhe atë;

1. Kompania ofertuese : Arbëri – NS, Sh.p.k, me seli në rrugën “ Adem Jashari “ 24000 Malishevë, me numër të biznesit, 810196859

Vlera e ofertës në emër të qiras për 99 vite është, 99.000.00 €

Vlera investive 650.000.00 €

Koha e realizimit 18 muaj.

2. Kompania ofertuese : Ilir Begaj B.I, N.T. “Alfa“, me seli në fshatin Banjë, KK-Malishevës, me numër të biznesit, 810704579.

Vlera e ofertës në emër të qirasë për 99 vite është, 89.100.00 €.

Vlera investive 350.000.00 €.

Koha e realizimit 24 muaj.

3. Kompania ofertuese NNT “ BURIMI – Agim Morina BI, me seli në rrugën “ Imer Krasniqi, në Malishevës, me numër të biznesit 810703571.

Vlera e ofertës në emër të qirasë për 99 vite është 128,700.00 €

Vlera investive 1,303.730.00 €.

Koha e realizimit 12 muaj.

Bazuar në nenin 21 paragrafi 4, të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. (09/2020) për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të komunës, shpallë ofertën më të favorshme ekonomike, për Komunën e Malishevës dhe atë ofertën e operatorit ekonomik;

NNT "BURIMI – Agim Morina BI, me seli në rrugën "Imer Krasniqi, në Malishevë,

Njoftimi do të publikohet në, tabelën e shpalljeve, faqën zyrtare të Komunës së Malishevës, NNT "BURIMI " AGIM Morina BI, me numër të biznesit 810703571 me vlerë të qirasë për periudhën prej 99 vitesh në shumën e mjeteve financiare prej 128,700.00 €, vlerë investive 1,303.730.00 € dhe kohën e realizimit prej 12 muaj.

Palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese, në Komisionin për Ankesa në kuadër të Komunës së Malishevës, i formuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 8 të Rregullorës dhe atë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi publikohet sot, me datë 02.05.2025.

Pas përfundimit të afatit për ankesa, ky Komision do të përgatisë raport me shkrim për punën e tij, i nëjti do të paraqitet për diskutim dhe votim në Kuvendin e Komunës së Malishevës, të njëjtit do t'i bashkëngjitet edhe kjo ofertë sipas thirrjes publike, pastaj mbetet në autoritetin dhe kompetencën e Kuvendit të Komunës së Malishevës, për procedurë të mëtejme, në lidhje me këtë çështje.

Komisioni vlerësues:

1. Muharrem Morina- Kryetari i Komisionit,
2. Halil Morina-anëtar,
3. Fitim Shala- anëtar,
4. Eqrem Morina- anëtar,
5. Ardian Mazreku-anëtar,



Vendi dhe data: Malishevë, më 02.05.2025.